



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 77

Tiranë – E hënë, 18 maj 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 50/2015, datë 30.4.2015	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 92/2014 “Për miratimin e përbërjes së komisionit hetimor të Kuvendit për verifikimin e ligshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore”, të ndryshuar..... 3435
Vendim i Kuvendit nr. 51/2015, datë 30.4.2015	Për mosmiratimin e projektligjit “Për hapjen e dosjeve të sigurimit të shtetit dhe procesin e lustracionit”..... 3435
Vendim i Kuvendit nr. 53/2015, datë 30.4.2015	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... 3435
Vendim i Kuvendit nr. 54/2015, datë 30.4.2015	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... 3435
Vendim i Kuvendit nr. 55/2015, datë 30.4.2015	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... 3436
Vendim i Kuvendit nr. 56/2015, datë 30.4.2015	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... 3436
Vendim i Kuvendit nr. 57/2015, datë 30.4.2015	Për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... 3436
Vendim i Kuvendit nr. 58/2015, datë 7.5.2015	Për miratimin e fondit nga buxheti i shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhjet vendore të vitit 2015..... 3436
Vendim i Kuvendit nr. 59/2015, datë 7.5.2015	Për zgjedhjen e kryetarit të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... 3437
Rezolutë e Kuvendit datë 30.4.2015	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2014..... 3437
Rezolutë e Kuvendit datë 30.4.2015	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2014..... 3439

Rezolutë e Kuvendit datë 30.4.2015	Për vlerësimin e punës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2014	3440
Rezolutë e Kuvendit datë 30.4.2015	Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2014.....	3441
Rezolutë e Kuvendit datë 7.5.2015	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) për vitin 2014.....	3443
Rezolutë e Kuvendit datë 7.5.2015	Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave që i përkasin komunitetit LGBT.....	3444
Udhëzim i ministrit të Financave, ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ministrit të Punëve të Brendshme, ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 3492, datë 30.4.2015	Për koordinimin ndërinstitucional të procedurave standarde të kontrollit sasior, cilësor dhe fiskal të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj në Republikën e Shqipërisë.....	3446
Kërkesë e ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 3522/1, datë 4.5.2015	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “Tokë bujqësore, arë, truall, kullotë” që preken nga “Ndërtimi i linjës 110 kv, Ersekë-Përmet”.....	3453
Kërkesë e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 2730, datë 7.5.2015	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Maminas-Gjiri i Lalzit”.....	3454
Kërkesë e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 2733, datë 7.5.2015	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Qafë Thanë-Lin-Pogradec loti II (shtesat).....	3455
Kërkesë e ministrit të Zhvillimit Urban nr. 1972/6, datë 7.5.2015	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Zgjerimi i rrugës “Don Gjon Buzuku”, rrijetësimi i sheshit të xhamisë “Iljaz Bej Mirahori”, rindërtimi i Kullës Historike të Sahatit rrijetësimi i sheshit të hyrjes, si dhe rikonstruksioni i disa rrugicave të Pazarit Historik”.....	3455
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Anri Maliqaj.....	3456

**VENDIM
Nr. 50/2015****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 92/2014 “PËR
MIRATIMIN E PËRBËRJES SË
KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT
PËR VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË
EMËRIMEVE NË DETYRË NË
ADMINISTRATËN SHTETËRORE,
ENTET PUBLIKE APO SHOQËRITË
TREGTARE SHTETËRORE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, dhe nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 92/2014 “Për miratimin e përbërjes së komisionit hetimor të Kuvendit për verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve në detyrë në administratën shtetërore, entet publike apo shoqëritë tregtare shtetërore”, të ndryshuar, në pikën I bëhet ky ndryshim:

“Voltana Ademi - Anëtare (PD)” zëvendësohet me “Liliana Elmazi - Anëtare (PD)”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miruar në datën 30.4.2015

**VENDIM
Nr. 51/2015****PËR MOSMIRATIMIN E PROJEKTLIGJIT
“PËR HAPJEN E DOSJEVE TË
SIGURIMIT TË SHTETIT DHE
PROCESIN E LUSTRACIONIT”**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 38, pika 6, e 55 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Mosmiratimin e projektligjit “Për hapjen e dosjeve të Sigurimit të Shtetit dhe procesin e lustracionit”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miruar në datën 30.4.2015

**VENDIM
Nr. 53/2015****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI
TË KËSHILLIT DREJTUES TË
RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Zoti Saimir Kumbaro zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miruar në datën 30.4.2015

**VENDIM
Nr. 54/2015****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES TË
RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Robert Rakiplari zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 30.4.2015

VENDIM
Nr. 55/2015

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES
TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Altin Shegani zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 30.4.2015

VENDIM
Nr. 56/2015

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES
TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Pashk Përvathi zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 30.4.2015

VENDIM
Nr. 57/2015

**PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KËSHILLIT DREJTUES
TË RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 94, pika 4, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Artan Peqini zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 30.4.2015

VENDIM
Nr. 58/2015

**PËR MIRATIMIN E FONDIT NGA
BUXHETI I SHTETIT PËR
FINANCIMIN E PARTIVE
PJESËMARRËSE NË ZGJEDHJET
VENDORE TË VITIT 2015**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 86, pika 2, e 87, pika 1, të ligjit nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Sasia e fondit nga Buxheti i Shtetit, që do t'u ndahet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, për zgjedhjet vendore të vitit 2015, është 65 milionë lekë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 7.5.2015

VENDIM
Nr. 59/2015

PËR ZGJEDHJEN E KRYETARIT TË
KËSHILLIT DREJTUES TË
RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 78, të Kushtetutës, të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit dhe të nenit 95, pika 3, shkronja “ç”, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Kristaq Traja zgjidhet Kryetar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 7.5.2015

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE
PËR VITIN 2014

Kuvendi i Shqipërisë,

- Duke konsideruar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi më i lartë i përhershëm shtetëror, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve dhe shpalljen e rezultatit të tyre;

- Duke vlerësuar se ushtrimi i funksioneve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për mbajtjen e zgjedhjeve të lira, demokratike, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, është me rëndësi vendimtare për garantimin e të drejtave themelore dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës;

- Duke mbajtur në konsideratë se veprimtaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të udhëhiqet nga parimet e integritetit, të paanësisë, të pavarësisë politike dhe institucionale, të transparencës, e të profesionalizmit;

- Duke besuar në rëndësinë e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me partitë politike, strukturat shtetërore, shoqërinë civile dhe të gjithë aktorët e tjerë, që kontribuojnë në realizimin e procesit zgjedhor sipas standardeve ndërkombëtare;

- Duke nënvizuar se zhvillimi i zgjedhjeve të përgjithshme, të barabarta, të lira, të fshehta dhe të drejtpërdrejta, në respektim të parimeve bazë të Trashëgimisë Elektorale Evropiane, Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias dhe të Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së, përbën përgjegjësinë themelore të veprimtarisë së KQZ-së;

Pas shqyrtimit të Raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mbi veprimtarinë e vitit 2014, konstaton se:

- Gjatë vitit 2014 KQZ-ja, ka realizuar përgjithësisht kërkesat dhe detyrat e lëna nga Kuvendi, me Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit, miraturar më 24.7.2014, për fokusimin në një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me zgjedhjet vendore të vitit 2015;

- Viti 2014 ka qenë një vit jozgjedhor;

- KQZ-ja gjatë vitit 2014, ka organizuar veprimtari për trajtimin, analizimin e aspekteve të ndryshme të procesit zgjedhor, për të evidentuar problematikat që lidhen me përgatitjen, administrimin dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve, si dhe adresimet për ndryshime ligjore në Kodin Zgjedhor, nëse është rasti, si dhe në aktet e nxjerra nga vetë KQZ, në aspektin organizativ;

- KQZ gjatë vitit 2014, në zbatim të detyrimit të Kodit Zgjedhor, nenit 21, pikat 9 dhe 10, jashtë periudhës zgjedhore, ka kryer trajnime për administrimin zgjedhor, si dhe programe edukimi me tematika të ndryshme, në zona të ndryshme zgjedhore;

- Gjatë vitit 2014, KQZ ka kryer veprimtari



paraprake si dhe ka marrë disa vendime për përgatitjen e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015, si reflektim i ndarjes së re Administrativo-Territoriale. Një numër i konsiderueshëm aktesh nuk janë miratuar ende, në respekt të afateve ligjore për përgatitjen e zgjedhjeve të 21 qershorit 2015;

- Lidhur me vlerësimin e mundësinë së aplikimit të teknologjisë së informacionit në procesin e zhvillimit të zgjedhjeve, SEN dhe SEV nuk rezultojnë që të jetë bërë ndonjë punë e veçantë. KQZ-ja ka funksionuar me 4 anëtarë, vendim-marrja për aplikimin e këtyre teknologjive kërkon shumicë të cilësuar. Si rrjedhojë ky detyrim i Kodit Zgjedhor nuk është përmbushur prej saj gjatë vitit 2014;

- Gjatë vitit 2014, lidhur me veprimtaritë e organizuara me partnerët ndërkombëtarë dhe vendas, KQZ-ja ka zhvilluar një sërë veprimtarish bashkëpunuese, si në plan ndërkombëtar ashtu edhe në nivel kombëtar, duke zgjeruar rrugët e bashkëpunimit, me qëllim fitimin e përvojave më të përparura ndërkombëtare për rritjen e performancës së institucionit në organizimin, administrimin dhe menaxhimin e të gjithë procesit zgjedhor;

- Gjatë vitit 2014, veprimtaria e KQZ-së, si në zhvillimin e mbledhjeve të Komisionit, ashtu edhe në të gjitha veprimtaritë e organizuara në funksion të përmbushjes së kërkesave ligjore, rekomandimeve ndërkombëtare dhe kombëtare dhe kërkesave të Rezolutës së Kuvendit, rezultojnë që të jetë transparente dhe e hapur për publikun.

Kuvendi, për vitin 2015, i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, fokusimin në këto drejtime:

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të vijojë me realizimin në mënyrë të përgjegjshme të detyrave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, si dhe në Planin Orientues të Veprimeve për zgjedhjet vendore të 21 qershorit 2015, me qëllim respektimin e standardeve për zhvillimin e zgjedhjeve të drejta, të lira dhe të ndershme;

2. Për zhvillimin e zgjedhjeve vendore 2015, KQZ-ja duhet të mbajë në vëmendje dhe të vijojë të përmbushë rekomandimet e Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE/ODIHR-it, që i adresohen veprimtarisë së saj dhe në mënyrë të veçantë forcimit të pavarësisë së organeve të administratës zgjedhore;

3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në bashkëpunim me pushtetin vendor, duhet të vijojë punën përgatitore për organizimin e zgjedhjeve vendore të vitit 2015, në zbatim të dispozitave përkatëse të Kodit Zgjedhor, si dhe të ndryshimeve që u reflektuan në të, si rezultat i ndarjes së re administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë, ndarje e cila afektoi edhe ndryshime në Kodin Zgjedhor;

4. Për vitin 2015, KQZ duhet të vijojë me përgatitjen dhe miratimin e të gjithë projektvendimeve dhe projektudhëzimeve që duhet të dalin në bazë dhe për zbatim të Kodit Zgjedhor për zgjedhjet vendore, duke i konsultuar ato gjerësisht me partitë politike;

5. KQZ-ja të vijojë punën me zhvillimin e programeve intensive të trajnimit të administratës zgjedhore, në bashkëpunim me partitë politike dhe programet e edukimit të zgjedhësve, veçanërisht për disa kategori të veçanta, si votuesit për herë të parë, votuesit me aftësi të kufizuara, votueset e gjinisë femërore, etj.;

6. Për të forcuar rolin e administratës në procesin zgjedhor, KQZ-ja të përpunojë masa administrative dhe ligjore, me qëllim vendosjen dhe garantimin e standardeve më të larta për një administratë bazuar në parimet e administrimit të shërbimit civil dhe veçanërisht në merita, profesionalizëm, të paanshme politikisht dhe transparente;

7. KQZ të vijojë punën për plotësimin e nevojave për infrastrukturën e përgatitjes dhe të zhvillimit të zgjedhjeve, duke i kërkuar edhe Qeverisë që të ofrojë mbështetje në këtë aspekt;

8. KQZ duhet të përmbushë detyrimin ligjor për hartimin e Planit të Veprimit për mundësinë e aplikimit të teknologjisë së informacionit në procesin e shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve;

9. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të vendosë dhe të ruajë raporte sa më të ngushta bashkëpunimi me të gjithë aktorët që janë pjesë e proceseve zgjedhore, me qëllim arritjen e objektivit për realizimin e zgjedhjeve të lira dhe të drejta;

10. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të punojë më shumë për të ushtruar autoritetin e vet ligjor për detyrimin e partive politike që të kryejnë dhe të publikojnë raportet vjetore të



auditimit financiar nga ekspertët kontabël të licencuar, duke i kërkuar Qeverisë, që të ofrojë mbështetjen e duhur financiare në këtë aspekt.

11. Për të rritur transparencën e financimit të fushatës zgjedhore, KQZ-ja të publikojë raportet paraprake të financimit të fushatës të forcave politike, përpara ditës së zgjedhjeve për të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet për qëllime fushate.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 30.4.2015

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AUTORITETIT TË KONKURENCËS
PËR VITIN 2014

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:

Veprimtaria e Autoritetit të Konkurrencës është ushtruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

Kuvendi vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës në drejtim të:

- Ndërgjegjësimit dhe rritjes së besimit të publikut në rolin e Autoritetit në mbrojtje të konkurrencës, e shprehur nëpërmjet rritjes së numrit të çështjeve të ankmuara pranë Autoritetit të Konkurrencës.

- Rritjes së numrit të ndërhyrjeve në treg dhe zgjerimit të llojeve të tregjeve, të cilat kanë qenë objekt i monitorimit dhe hetimeve në zbatim të ligjit.

- Konsolidimit të institucionit të konkurrencës nëpërmjet përmirësimit të nivelit të ekspertizës dhe forcimit të kapaciteteve institucionale, si një nga faktorët kryesorë për pavarësinë reale të institucionit të konkurrencës.

- Plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ, duke synuar përafrimin me standardet ndërkombëtare, në kuadër të përmbushjes së angazhimeve të institucionit dhe të vendit për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Europian.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës, për vitin 2015, të përmirësojë punën në drejtim të:

- Monitorimit në mënyrë të vazhdueshme të tregjeve prioritare, që kanë qenë objekt hetimi apo monitorimi nga Autoriteti i Konkurrencës më parë

si: tregu i telefonisë celulare, tregu i importit dhe shitjes me shumicë të gazit, tregu i sigurimeve, tregu i karburanteve, tregu i energjisë, tregu i shërbimit të transportit ajror, tregu i transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve, për të ndjekur sjelljen e firmave në treg.

Ndjekja në vazhdimësi është e rëndësishme për të mundësuar zbatimin konkret të rekomandimeve të dhëna, me qëllim vendosjen dhe ruajtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në këto tregje.

- Shpeshimit të inspektimeve në formën “*Dawn raids*” me nismën e vetë Autoritetit në tregjet me kërkesa cilësore e të ndjeshme ndaj shpenzimeve konsumatore, me qëllim parandalimin dhe zbulimin e praktikave antikonkurrese.

- Angazhimit në vazhdimësi në procese trajnimi të gjyqësorit administrativ të të gjitha shkallëve për të thelluar njohuritë në fushën e së drejtës së konkurrencës, për të mundësuar një rishikim gjyqësor sa më objektiv në interesin publik të vendimeve të Autoritetit dhe të konkurrencës, si një e mirë publike, duke qenë se efica e ndërhyrjes së institucionit të konkurrencës në treg kushtëzohet në mënyrë të ndjeshme nga zbatimi i vendimeve të tij.

- Nxitjes së mëtejshme të përhapjes së advokacisë e kulturës së konkurrencës nëpërmjet bashkëpunimit proaktiv, me anë të aktiviteteve të përbashkëta me komunitetin e biznesit, për të vlerësuar perceptimin e biznesit mbi nivelin e njohjes së filozofisë së konkurrencës dhe zbatimit të ligjit e për të siguruar që veprimtaria e tyre të jetë në përputhje me rregullat e konkurrencës.

- Forcimit të rolit të institucionit si mbrojtës i interesave të qytetarëve nëpërmjet zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Kuvendi i kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës:

- Duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës në dhënien e miratimit e akteve, që kanë si objekt ose pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore në tregje ose sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

- Për konsultime të përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore.



- Për të paraqitur në kohën e duhur pranë Autoritetit të Konkurrencës gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar për monitorimin e tregjeve apo hetimin e praktikave që deformojnë konkurrencën në treg.

KRYETARI
I Ilir Meta

Miraturar në datën 30.4.2015

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË
INSPEKTORATIT TË LARTË TË
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË
INTERESAVE PËR VITIN 2014

Kuvendi i Shqipërisë:

Duke konsideruar luftën kundër korrupsionit si prioritetin kyç për forcimin e shtetit të së drejtës, zhvillimin ekonomik e social të vendit, si dhe një ndër kushtet thelbësore për integrimin e mëtejshëm të vendit për anëtarësim në BE;

Duke vlerësuar se ILDKPKI-ja është një institucion me rol thelbësor në zbulimin dhe ndëshkimin e rasteve të korrupsionit, pasurive të paligjshme dhe konfliktit të interesit në radhët e funksionarëve të lartë të shtetit, administratës publike, sistemit gjyqësor dhe një sërë subjektsh të tjera të ligjit;

Duke theksuar se integriteti, pavarësia dhe zbatueshmëria e ligjit në mënyrë të paanshme dhe transparente nga ky institucion, krahas bashkëveprimit me të gjitha institucionet ligjzbatuese në vend, janë faktorët kryesorë për arritjen e rezultateve të prekshme në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, për forcimin e shtetit ligjor;

Duke inkurajuar e mbështetur institucionin e ILDKPKI-së, si organi kyç në luftën anti-korrupsion;

Duke mbështetur në vijimësi veprimtarinë e ILDKPKI-së për përmirësimin në tërësi të legjislacionit bazë, për forcimin e kapaciteteve administrative e financiare dhe të instrumenteve ligjore, me qëllim përmbushjen e misionit ligjor institucional për zbulimin e praktikave të pasurimit korruptiv, si dhe në parandalimin e konfliktit të interesit;

Konstaton dhe vlerëson se ILDKPKI-ja për vitin 2014:

Ka përmbushur objektivat e pritshëm, të përcaktuar në rezolutën e Kuvendit, të lëna për
Faqe | 3440

vitin 2014.

Ka një nivel shumë të lartë treguesish në krahasim me treguesit e punës, të realizuar në vitin pararendës, por krahasuar edhe me të gjithë treguesit e punës së institucionit të ILDKPKI-së në vite.

Ka arritur një sërë rezultatesh konkrete në të tria llojet e kontroleve, hetimit lidhur me zbulimin e fshehjeve të pasurisë, si dhe në zbulimin e shkeljeve të ndryshme të ligjit për deklarimin e interesave privatë, duke vendosur, si asnjë vit tjetër, një numër të lartë e të konsiderueshëm sanksionesh penale dhe veprime të tjera administrative.

Ka çuar para organit të akuzës, si asnjë vit tjetër, një numër rekord prej 114 kallëzimesh penale si dhe ka vendosur një numër të lartë prej 474 masash administrative me gjobë për rastet konkrete të hetuara.

Ka punuar intensivisht për krijimin e regjistrit të konfliktit të interesit, si një hap konkret në përmirësimin e zbatimit të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave dhe ka treguar pritshmëri të mira në gjurmimin e konfliktit të interesit, si dhe parandalimin dhe ndëshkimin e rasteve të konfliktit të vazhdueshëm të interesave.

Ka shprehur angazhim serioz për të kapërcyer me sukses problematikat në funksionimin institucional, që kishte trashëguar nga një vit më parë, si dhe ka zbatuar në afatet e caktuara ligjore detyrimet e vitit, duke përmirësuar ndjeshëm aspektet e punës institucionale;

Ndryshimet ligjore në prill 2014, miratimi i shtesave në strukturë dhe shtimi i fondeve buxhetore janë përthithur më së miri nga ky institucion, duke rritur ndjeshëm forcën goditëse dhe imazhin institucional si organ kontrolli antikorrupsion.

Ka zhvilluar aktivitete ndërgjegjësuë trajnuese me autoritetet përgjegjëse, si dhe ka riaktivizuar bashkëpunimin ligjor dhe institucional me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Ka ndjekur dhe realizuar një politikë të hapur të transparencës institucionale, duke rritur komunikimin me publikun dhe me median, duke publikuar me kërkesë më shumë se 2100 deklarata të interesave privatë vetëm gjatë vitit 2014.

Ka nxjerrë të gjitha aktet e nevojshme nënligjore në refleksim të zbatimit të ndryshimeve të bëra në kuadrin ligjor e të funksionimit të tij.



Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2015, kërkon nga ILDKPKI-ja të ketë në fokus të punës së saj:

- Konsolidimin e pavarësisë dhe integritetit institucional, si dhe garantimin e transparencës dhe frymës së llogaridhënies;

- Forcimin e sistemit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive, nëpërmjet hetimeve administrative proaktive, sidomos në pasuritë e pajustificuara të funksionarëve të niveleve të larta;

- Angazhimin institucional, me qëllim mundësimin e deklarimeve online të pasurisë për të gjitha subjektet deklaruese dhe publikimin e deklarave të interesave privatë pa kërkesë apo në mënyrë automatike, nëpërmjet përdorimit në mënyrë efektive të ekspertizës dhe ndihmës së huaj;

- Fokusimin e punës te çështjet e konfliktit të interesave, evidentimit të tij përmes krijimit të aksesit të drejtpërdrejtë në database-n elektronike në institucionet kyç për konstatimin e rasteve të konfliktit të interesave, si dhe funksionimit më të mirë të regjistrit të konfliktit të interesit;

- Vlerësimin e zbatimit të Rekomandimeve të GRECO-s, në raundin e katërt, lidhur me deklarimin dhe kontrollin e pasurisë dhe parandalimin e konfliktit të interesave në radhët e deputetëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve;

- Angazhimin për zbatimin në kohë të detyrimeve që rrjedhin nga objektivat e masat e parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, si dhe ato të diktuar nga Prioritet 2 dhe 3 të Udhërrëfyesit për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian;

- Forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me institucionet ligjzbatuese në fushën e antikorrupsionit e kryesisht me organin e akuzës;

- Përmirësimin e shkëmbimit të të dhënave me institucionet e administratës publike, duke mundësuar prej tyre aksesin e vazhdueshëm, si dhe konkretizimin e bashkëveprimit me plane të përbashkëta, sipas memorandumeve të nënshkruara;

- Rritjen e kapaciteteve profesionale dhe trajnimin e vazhdueshëm të strukturave të autoriteteve përgjegjëse, veçanërisht për çështje të parandalimit, identifikimit dhe trajtimit të konfliktit të interesave rast pas rasti;

- Bashkëveprimin gjithëpërfshirës me Kuvendin e Shqipërisë, për çështje ligjore dhe të përmirësimit të performancës institucionale.

KRYETARI

Ilir Meta

Miraturar në datën 30.4.2015

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL PËR VITIN 2014

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson se:

- Duke njohur rolin e këtij institucioni të pavarur, që ligji i ri “Për nëpunësin civil” ka ridimensionuar për Komisionerin e Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil, si struktura shtetërore që mbikëqyr menaxhimin e shërbimit civil në nivel qendror e vendor;

- Duke nxitur institucionin e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil që të bëhet promotor i zhvillimit të reformave në administratën publike, në kuadër të përmbushjes së 5 Prioriteteve për integrimin në Bashkimin Europian;

- Duke konsideruar si prioritet kombëtar reformimin e administratës publike, në kuadër të integritetit në Bashkimin Europian, këmbëngul në krijimin e një performace të plotë të këtij institucioni;

- Duke theksuar rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve ndërinstitucionale ndërmjet Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil dhe institucioneve të tjera ligjvënëse, ekzekutive, gjyqësore dhe atyre të pavarura;

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2014:

1. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2014 ka ushtruar një veprimtari të kufizuar, për shkak se është zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 85/2014, në datën 30.10.2014, si dhe për shkak se Sekretariati Teknik, në mbështetje të veprimtarisë së tij, ka filluar punën pas miratimit nga ana e Kuvendit të Shqipërisë të vendimit nr. 98/2014, datë 4.12.2014, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”. Sekretariati Teknik ende nuk është plotësuar me punonjësit, sipas



strukturës të miratuar nga Kuvendi me vendimin e mësipërm, për shkak se këto procedura, sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, kërkojnë kohë.

2. Një sërë detyrimesh ligjore, që burojnë nga ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk janë realizuar për shkaqet e përmendura më sipër. Komisioneri ka filluar të kryejë inspektime/mbikëqyrje në një sërë institucione, për rezultatet e të cilave nuk mund të flitet, pasi një pjesë e tyre janë ende të papërfunduara.

3. Inspektimet e deritanishme janë zhvilluar në një numër të kufizuar subjektsh, duke përzgjedhur institucione me tipologji të ndryshme, si institucione të pavarura dhe të krijuara me ligj, institucione të administratës qendrore dhe njësi të qeverisjes vendore.

4. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka qenë aktiv në rastin e inspektimeve me kërkesë nga punonjës të institucioneve të ndryshme. Kjo situatë dëshmon edhe për sensibilitetin e problematikave dhe ndërgjegjësimin për rolin e Komisionerit.

5. Disa institucione kanë reaguar në mënyrë të shpejtë dhe të drejtë pas inspektimeve të Komisionerit dhe rekomandimeve të tij, duke dëshmuar edhe në këtë rast se këto institucione njohin dhe vlerësojnë rolin dhe autoritetin e institucionit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

6. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka kryer tre lloj mbikëqyrjesh, si mbikëqyrje e orientuar/përgatitore, mbikëqyrje e përgjithshme dhe inspektim i përgjithshëm /tematik në një sërë institucione të administratës shtetërore, institucione të pavarura dhe njësi të qeverisjes vendore.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2015 kërkon:

1. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në vëmendje edhe të rekomandimeve të Progresraportit të BE-së për vitin 2014, të përmbushë misionin e tij ligjor për garantimin e zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në të gjitha subjektet që përfshihen në fushën e shërbimit civil, në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, me qëllim krijimin e një shërbimi civil

të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet, moral dhe paanësi politike.

2. Të kryejë inspektime/mbikëqyrje në të gjitha institucionet, të cilat trajtohen sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në mënyrë që në raportimin e radhës në Kuvendin e Shqipërisë të kemi një pasqyrë sa më gjithëpërfshirëse dhe të gjerë të zbatimit të ligjit, si dhe të problematikave që do të rezultojnë.

3. Nisur nga fakti që vetë Komisioneri ka konstatuar se subjektet e administrimit të shërbimit civil kanë dëshmuar kuptim jo të drejtë të ligjit, për pasojë edhe zbatim jo të drejtë të tij, rekomandohet organizimi i trajnimeve nga ana e Komisionerit të Mbikëqyrjes për Shërbimin Civil, në bashkëpunim me ASPA-n (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike), trajnime lidhur me çështjet që gjykohen si më problematike.

4. Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil të bashkëpunojë në mënyrë të vazhdueshme me institucione të tjera të ngarkuara për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si Departamenti i Administratës Publike, dhe të hartojë studimin përkatës për evidentimin e fenomeneve dhe statistikave të pozicioneve të punës në njësitë e qeverisjes vendore, të cilat do të reformohen sipas ndarjes së re territoriale.

5. Të vijojë praktikën e ndjekur prej tij gjatë këtyre muajve, për të kryer sa më tepër inspektime në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, pavarësisht marrjes së informacioneve nga ana e institucioneve me kërkesë të tij.

6. Nëse gjatë veprimtarisë së tij për zbatimin e ligjit, Komisioneri i Mbikëqyrjes për Shërbimin Civil konstaton që ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka nevojë për ndryshime, mund t’i propozojë Kuvendit ndërhyrjet ligjore përkatëse.

7. Të planifikojë dhe të kryejë veprimtari dhe fushata ndërgjegjësuere lidhur me zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për të gjithë nëpunësit civilë, me qëllim njoftimin në lidhje me çdo paligjshmëri të konstatuar në shkelje të të drejtave të tyre nga të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

8. Të vendosë kontakte dhe të nisë bashkëpunimin me institucione homologe rajonale dhe



europiane, në mënyrë që të mundësojë marrjen dhe përdorimin e përvojës së vendeve të tjera dhe standardeve europiane në përmbushje të misionit të tij.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 30.4.2015

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AUTORITETIT TË MEDIAVE
AUDIOVIZIVE (AMA) PËR VITIN 2014

Kuvendi i Shqipërisë:

Duke qenë i vetëdijshëm se sektori audiovisual ndodhet në sfidat e tij të mëdha për pavarësi dhe efikasitet cilësor editorial, të zhvillimit të teknologjive të reja, sipas standardeve europiane dhe përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare për procesin e digjitalizimit;

Duke vlerësuar se bordi rregullator i AMA-s ka një rol të rëndësishëm në përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe duhet të garantojë pavarësi, paanshmëri dhe efikasitet për të kryer funksionet e ngarkuara sipas ligjit;

Duke shprehur vullnetin e tij për mbështetjen e institucionit të AMA-s në implementimin e ligjit dhe arritjen e objektivave të tij institucionale, me qëllim sigurimin e lirisë së shprehjes dhe medias, si dhe përmbushjen sa më të mirë të nevojave të qytetarëve nga ofrimi i shërbimeve audiovizive;

Vëren se:

1. Veprimtaria e AMA-s, gjatë vitit 2014, duhet të ishte realizuar sipas kërkesave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

2. Viti 2014 duhet të ishte viti i funksionimit të një bordi të plotë në anëtarësinë e tij dhe me një sërë vendimmarrjesh të rëndësishme dhe konfigurimesh strukturore të institucionit.

3. AMA, gjatë vitit 2014, është përballur me mungesa të theksuara të përfaqësimit dhe të kuorumit për përmbushjen e objektivave të saj ligjorë.

4. AMA nuk ka mundur të zbatojë kërkesat e Kuvendit, të shprehura në rezolutën e vlerësimit të veprimtarisë së saj gjatë vitit 2013.

5. Si pasojë, edhe pritshmëritë për zbatimin e ligjit dhe rekordet e tij rezultojnë të ulëta.

6. Vetë Kuvendi, përmes procedurave të tejzgjatura, ka vonuar proceset e plotësimit në kohë të vendeve vakante të bordit të AMA-s, duke ndikuar në mospërmbushjen e shumë proceseve vendimmarrëse të kësaj të fundit.

Për rrjedhojë, situata e veprimtarisë së AMA-s, gjatë vitit 2014, në një pjesë të konsiderueshme të vitit ka rezultuar me:

1. Mospërmbushje të funksioneve dhe detyrimeve ligjore të natyrës ligjore, vendimmarrëse teknike dhe financiare.

2. Mosmiratim të disa akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA-ve.

3. Shtim të fenomenit të piraterisë në transmetimet audiovizive.

4. Mangësi të mëdha në administrimin e spektrit të frekuencave për transmetime audiovizive, si pasojë e zënies së brezit të frekuencave në kundërshtim me ligjin.

5. Pamundësi pajisjesh për të kryer monitorimin në shumë zona.

6. Pamundësi të ekzekutimeve të vendimeve të AMA-s, të cilat kanë sjellë një ulje të ndjeshme të autoritetit të këtij institucioni.

7. Mosrespektim të afateve ligjore në realizimin e procesit të kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike.

Kuvendi gjithashtu vlerëson se:

Pavarësisht problematikave serioze dhe trashëgimit të një situatë të mangët institucionale, në pjesën e fundvitit e në vijim ka pasur një përpjekje nga bordi i ri për të identifikuar problematikën dhe për të marrë masat emergjente për përmirësimin e situatës institucionale dhe ligjore të veprimtarisë së saj.

Kuvendi nxit dhe kërkon nga AMA për vitin 2015:

1. Zbatimin me përpikëri të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, duke përmbushur objektivat dhe detyrimet që burojnë prej tij, me qëllim rritjen e nivelit të impaktit të ligjit dhe imazhit institucional të AMA-s.

2. Angazhim maksimal për përmbushjen e të gjitha hallkave të procesit të kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike.



3. Koordinim me RTSH-në për përmbushjen e detyrimeve ligjore të përbashkëta, lidhur me procesin e kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike dhe ndjekjen e koordinimit reciprok pas nënshkrimit të kontratës për ndërtimin e rrjeteve numerike të RTSH-së.

4. Miratimin e akteve nënligjore dhe zbatimin e plotë të tyre.

5. Miratimin e Rregullores së Brendshme të institucionit, me qëllim detajimin e procedurave të punës për çdo drejtori.

6. Bashkëpunimin me institucionet e tjera shtetërore për zbatimin e sanksioneve ligjore për shkeljet e OSHMA-ve.

7. Zhbllokimin e procesit të licencimit të rrjeteve numerike private kombëtare.

8. Ngritjen e Këshillit të Ankesave dhe funksionimin e tij, me qëllim identifikimin dhe analizimin e etikës së komunikimit audioviziv, raportet e së drejtës për informim dhe së drejtës për privatësi, për përparësinë e mbrojtjes së interesit publik dhe respektimin e dinjitetit të individit.

9. Garantimin për përmbushjen e funksioneve dhe përgjegjësiwe ligjore të secilit anëtar, të zgjedhur nga Kuvendi i Shqipërisë, duke siguruar pjesëmarrjen dhe vendimarrjen e anëtarëve të AMA-s në të gjitha mbledhjet e saj gjatë vitit 2015.

10. Organizimin e fushatës për informimin e publikut përmes emisioneve televizive, publikimit të artikujve në shtypin e shkruar, reklamave dhe spoteve televizive, broshurave informuese, si dhe organizimin e konferencave kombëtare me aktorët e tregut audioviziv për kuadrin rregullator dhe mënyrat e kalimit nga transmetimet analoge në transmetimet numerike.

11. Rritjen e transparencës së institucionit, në kuadër të informimit publik, dhe llogaridhënies, duke pasqyruar çdo vendimarrje apo aktivitet të këtij institucioni.

12. Realizimin e planit financiar dhe menaxhimin efikas të të ardhurave dhe shpenzimeve financiare, në funksion të objektivave të institucionit.

13. Modernizimin e studios së monitorimit, për t'iu përshtatur në mënyrë të plotë procesit të kalimit të transmetimeve audiovizive nga analoge në numerike.

14. Përcaktimin e një strategjie të zhvillimit të sistemeve kabllore në Shqipëri, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve dhe sigurimin e një tregu të qëndrueshëm të transmetimeve kabllore.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 7.5.2015

REZOLUTË
PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE
LIRIVE TË PERSONAVE QË I PËRKASIN
KOMUNITETIT LGBT

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik dhe kushtetues në Shqipëri;

Parimin e barazisë dhe të së drejtës së jetës me dinjitet të personave që i përkasin komunitetit të Lesbikëve, Gay-ve, Biseksualëve dhe Transgjinjorëve (LGBT), si persona që duhet të gëzojnë të drejta të barabarta me çdo shtetas në Republikën e Shqipërisë;

Zhvillimet e legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore për komunitetin LGBT;

Rolin e institucioneve të pavarura të të drejtave të njeriut në tërësi dhe atë të Avokatit të Popullit në veçanti për nxitjen, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe mbështetjen që japin për ndërgjegjësimin e institucioneve shtetërore, shoqërisë civile, shoqërisë shqiptare, mes raporteve të veçanta për Kuvendin e Shqipërisë, rekomandimeve të adresuara, bashkëpunimit me organizatat që mbrojnë të drejtat e komunitetit LGBT etj.;

Rolin e organizatave të shoqërisë civile në mbrojtjen dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë sonë në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të komunitetit LGBT në veçanti, në denoncimin e rasteve të diskriminimit dhe mobilizimin shoqëror të komunitetit LGBT për të sjellë një ndryshim pozitiv shoqëror në vend.

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:

Shqipëria, përgjatë pesë viteve të fundit, ka bërë përparime të ndjeshme në drejtim të garantimit të të drejtave për çdo person që i



përket komunitetit LGBT, duke u renditur ndër vendet ku mbrojtja nga diskriminimi, për arsye të orientimit seksual ose identitetit gjinor, është pjesë integrale e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Kontributi i Kuvendit të Shqipërisë, Qeverisë Shqiptare, institucioneve të saj, organizatave të të drejtave të njeriut dhe shoqërisë civile të komunitetit LGBT në vend është rritur.

Shqipëria ka shënuar progresin e radhës në drejtim të përafrimit të legjislacionit me direktivat e Bashkimit European, duke parashikuar shprehimisht në Kodin e Procedurave Administrative, të miratuar së fundi në Kuvendin e Shqipërisë, orientimin seksual, identitetin gjinor dhe përkatesinë në një grup të caktuar, si shkaqe ndaluese nga diskriminimi, si dhe kalimin e barrës së provës nga personi që pretendon një sjellje diskriminuese në procedurat administrative të pala tjetër dhe/ose organi publik.

Raporti i veçantë i Avokatit të Popullit për personat LGBT, i depozituar në Kuvendin e Shqipërisë, adreson problematikat e komunitetit LGBT dhe rekomandimet për institucionet qendrore dhe Kuvendin e Shqipërisë, me qëllim përmirësimin e të drejtave të personave LGBT.

Avokati i Popullit ka adresuar disa rekomandime legjislative për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor për garantimin e një mbrojtjeje më të mirë të të drejtave të personave që i përkasin komunitetit LGBT. Rekomandimi i Avokatit të Popullit për ndryshimin e Kodit Penal u përmbush nga Kuvendi i Shqipërisë me ndryshimet e bëra në Kodin Penal, në vitin 2013. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ka pranuar që rekomandimet ligjore të Avokatit të Popullit të përfshihen në paketën e re të ndryshimeve që do i bëhen Kodit të Punës.

Raporti i veçantë i Avokatit të Popullit rekomandon që Ministria e Arsimit dhe e Sportit të trajnojnë mësuesit, me qëllim arsimimin e fëmijëve në një mjedis të sigurt, pa dhunë, fyerje, përjashtim social ose trajtim çnjerëzor, për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor.

Diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, të shoqërimit, të shprehjeve gjinore etj. mbetet ende një shqetësim në jetën e shumë personave LGBT dhe kërkon angazhimin e mëtejshëm të Kuvendit të Shqipërisë, Qeverisë dhe shoqërisë në tërësi për parandalimin,

sensibilizimin dhe zbatimin e legjislacionit për parandalimin e diskriminimit.

Kuvendi i Shqipërisë:

Inkurajon hartimin e një Plani Kombëtar Veprimi për masat dhe mbrojtjen e të drejtave të personave LGBT. Ky plan duhet të hartohet mes një procesi gjithëpërfshirës me pjesëmarrjen e të gjitha institucioneve që mbulojnë çështje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Inkurajon Qeverinë Shqiptare të miratojë ndryshimet ligjore të nevojshme, në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit, për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT në periudhën 2012-2014, pjesë e Udhërrëfyesit mbi 5 prioritetet për hapjen e negociatave të anëtarësimit në BE.

Angazhohet të miratojë rekomandimet legjislative të Avokatit të Popullit, për shtesat e ndryshimet në Kodin të Punës, në përputhje të plotë me përcaktimet e nenit 10 të Direktivës 2000/78 EC, të Këshillit të Bashkimit European.

Inkurajon të gjitha institucionet shtetërore të zbatojnë Rekomandimin CM/Rek (2010)5 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës “Për masat për luftën kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor”.

Nxit Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve që të trajnojë stafin mësimor për mbrojtjen më të mirë të të drejtave të personave LGBT, me qëllim moslejimin e çdo forme diskriminimi të tyre, për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, zhvillimin e veprimtarive kulturore kundër homofobisë në institucionet arsimore, me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të komunitetit LGBT.

Nxit Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë që, nëpërmjet Inspektoratit Shtetëror të Punës, të kontrollojë zbatimin nga punëdhënësit të dispozitave ligjore që pritet të ndryshohen, në mënyrë që të garantojë zbatimin e tyre në praktikë nga punëdhënësit publikë ose privatë.

Inkurajon institucionin e Avokatit të Popullit të monitorojë respektimin e të drejtave dhe lirive kushtetuese e ligjore të personave LGBT në Shqipëri, si dhe të masave që duhet të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse për respektimin e tyre.



Mbështet organizatat e shoqërisë civile për ndërgjegjësimin publik dhe nxit Qeverinë Shqiptare të bashkëpunojë për parandalimin e diskriminimit ndaj komunitetit LGBT.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 7.5.2015

UDHËZIM
Nr. 3492, datë 30.4.2015

**PËR KOORDINIMIN
NDËRINSTITUCIONAL TË
PROCEDURAVE STANDARDE TË
KONTROLLIT SASIOR, CILËSOR DHE
FISKAL TË NAFTËS BRUTO DHE
NËNPRODUKTEVE TË SAJ NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008, “Për metrologjinë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9876, datë 14.12.2008, “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve djegëse, të rinovueshme për transport”, të ndryshuar, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 609, datë 24.8.2011 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënie me koncesion të shërbimit të markimit dhe monitorimit të karburanteve”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 13.3.2013 “Për miratimin e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Global Fluids International” S.A. dhe “Petroleum Consulting Partners” A.G”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 612, datë 5.9.2012,

Faqe|3446

“Për dispozitat zbatuese të ligjit, “Për akcizat”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.4.1999, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 919, datë 29.12.2014, “Për miratimin e dispozitave zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 498, datë 30.5.2013, “Për përcaktimin e procedurave të shënimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 31.7.2013 “Për një ndryshim në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 498, datë 30.5.2013 “Për përcaktimin e procedurave të shënimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të naftës”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 781, datë 14.11.2007, “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike, të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen, me autorizim, të shoqërive të autorizuar për ofrimin e pajisjeve fiskale”, të ndryshuar, ministri i Financave, ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe ministri i Punëve të Brendshme,

UDHËZOJNË:

Ndjekjen e procedurave të mëposhtme për koordinimin ndërinstitutional dhe shkëmbimin e informacionit për trajtimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e veprimtarisë së importit, eksportit, prodhimit, depozitimit dhe transportimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, me synim parandalimin e shmangieve sasiore, cilësore dhe fiskale.

1. Institucionet përgjegjëse

Procedurat e parashikuara në këtë udhëzim ndiqen dhe zbatohen nga:

- a) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD);
- b) Inspektorati Shtetëror Përgjegjës (ISHP);
- c) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT);
- d) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM);
- e) Shoqëria Koncesionare e Markimit (GFI);



f) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN);

g) Drejtoria e Policisë së Shtetit (DPSH);

2. Procedurat e trajtimit, të mbikëqyrjes dhe të kontrollit sasior, cilësor dhe fiskal në rastet e importit detar të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj:

2.1 Vendosja në magazinë të lirë

Me konfirmimin e mbërritjes së anijes nga Kapitaneria e Portit ndiqen procedurat e mëposhtme:

i) Kryhet matja e produktit në bordin e anijes në prezencë të degës doganore, Antikontra-bandës Detare, survejorit të licencuar dhe përfaqësuesit të subjektit.

ii) Merret mostra e produktit nga DPD-ja për efekt të përcaktimit të klasifikimit tarifor.

iii) Merret mostra e produktit nga ISHP-ja për kryerjen e kontrollit cilësor, e cila analizohet brenda 12 orëve dhe raporti i analizës i dërgohet menjëherë DPD-së.

iv) Në rast se sipas raport-analizës, konform pikës “iii” më sipër, rezulton se produkti është në përputhje me standardet e miratuara, procedohet me shkarkimin e tij nga anija. Në të kundërt DPD-ja procedon në zbatim të legjislacionit në fuqi.

v) Në rast se produkti do të shkarkohet në depozita, matet gjendja e depozitave ku do të shkarkohet produkti në prezencë të survejorit, DPD dhe subjektit importues.

vi) Pas shkarkimit, me depozitim të produktit në ambientet e magazinës së lirë dhe verifikimit fizik të tij nëpërmjet matjes, kryhet procedura e mbylljes doganore DAV- Import7 përkatës. Nëse konstatohen diferenca, veprohet sipas procedurave doganore (mangut -Imp9 dhe teper-imp7).

2.2 Destinacionet doganore

Produkti i magazinuar mund të vendoset në qarkullim të lirë ose të rieksporthet.

2.2.1 Vendosja në qarkullim të lirë

i) Subjekti bën deklarin e produktit për zhdoganim

ii) Koncesionari i markimit kryen procedurën e markimit të produktit

iii) DPD-ja kryen procedurën e zhdoganimit duke pranuar praktikën doganore të importit dhe vendos produktin në qarkullim të lirë sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Praktika doganore import 4 përmban deklarin e thjeshtuar, deklaratën doganore, faturë shitjeje, kupon tatimor, leximin e pajisjes matëse për ngarkesën e kryer, konfirmimin e shërbimit të markimit nga GFI-ja dhe raport-analizën e ISHP.

2.2.2. Riekспорт

i) Subjekti depoziton deklaratën doganore të rieksporit, nëpërmjet së cilës bën deklarin e produktit për riekспорт.

ii) DPD pranon praktikën doganore për riekспорт dhe rivendos mallrat në regjim transiti sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

iii) Në rast konstatimi të elementeve të veprës penale, DPD-ja njofton sipas shkallës së emergjencës (telefon, fax, e-mail, shkresë) DPSH-në, DPT-në dhe ISHP-në duke kërkuar bashkëpunimin dhe koordinimin në kryerjen e veprimeve të para hetimore deri në referimin e veprës penale prokurorisë kompetente. Në rastet kur strukturat e tjera të procedimit penal kanë informacion për prezencën e veprave penale, njoftojnë autoritetet doganore dhe tatimore.

3. Procedurat e trajtimit, mbikëqyrjes dhe kontrollit sasior, cilësor dhe fiskal në rastet e importit tokësor të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj:

i) Me mbërritjen në pikën doganore tokësore, subjekti bën deklarin e produktit pranë autoriteteve doganore.

ii) Merret mostra e produktit nga DPD-ja për efekt të përcaktimit të klasifikimit tarifor.

iii) Merret mostra e produktit nga ISHP për kryerjen e kontrollit cilësor, e cila analizohet brenda 4 ditëve pune dhe raporti i analizës i dërgohet menjëherë DPD-së. Për efekt procedure doganore ISHP konfirmon menjëherë cilësinë e produktit mbi bazën e certifikatës së origjinës (certifikatë konformiteti).

iv) Koncesionari i markimit (GFI) kryen procedurën e markimit të produktit.

v) DPD-ja kryen procedurën e zhdoganimit duke pranuar praktikën doganore të importit dhe vendos produktin në qarkullim të lirë sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

vi) Praktika doganore e importit që shoqëron dhe produktin gjatë transportit, përmban deklaratën doganore, faturën e blerjes, konfirmimin e shërbimit të markimit nga GFI, certifikatë konformiteti nga ISHP-ja.



3.1 Tregtimi me shumicë

i) Merret mostra e produktit nga ISHP-ja për kryerjen e kontrollit cilësor sipas procedurave ligjore në fuqi, e cila analizohet brenda 4 ditëve pune dhe raporti i analizës i dërgohet menjëherë subjektit.

a) Në rast se nga raport i analizave rezulton se produkti është në përputhje me standardet e miratuara, lejohet tregtimi i tij.

b) Në rast se nga raport-analiza rezulton se produkti nuk plotëson këto standarde, procedohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999.

ii) Hedhja në treg e produktit realizohet nëpërmjet instrumenteve matës si kontaliter dhe peshore automobilistike, të cilat duhet të jenë të verifikuara nga DPM. Në rast mosvlerësimi konformiteti (mosverifikimi) të instrumentit matës, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9875, datë 14.2.2008.

iii) Koncesionari i markimit (GFI) dhe DPD kryejnë procedurat e monitorimit të produktit.

iv) Në rast se nga shërbimi i monitorimit të markimit konstatohen produkte të pafiskalizuar, procedohet me masat ligjore sipas legjislacionit në fuqi nga ana e DPD-së. Në rast të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm sipas legjislacionit tatimor, si dhe pajisjes fiskale, informohet DPT-ja, ISHP-ja dhe DPSH-ja.

v) Kontrolli i sistemit të monitorimit të qarkullimit bëhet nga strukturat e hetimit tatimor apo të kontrollit tatimor.

Në rast konstatimi të:

- mungesës /dëmtimit të sistemit të monitorimit të qarkullimit;
- të dhënave të patransmetuara;
- përdorimit manual të sistemit;
- subjektet penalizohen sipas ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

3.2 Tregtimi me pakicë

i) Merret mostra e produktit nga ISHP-ja për kryerjen e kontrollit cilësor, e cila analizohet sipas procedurave në fuqi dhe raporti i analizës i dërgohet menjëherë subjektit.

a) Në rast se nga raporti i analizave rezulton se produkti është në përputhje me standardet e miratuara, lejohet tregtimi i tij.

b) Në rast se nga raport-analiza rezulton se produkti nuk plotëson këto standarde, procedohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8450, datë 24. 2.1999.

ii) Hedhja në treg e produktit realizohet nëpërmjet instrumenteve matëse shpërndarëse të karburantit, të cilët duhet të jenë verifikuar nga DPM-ja. Në rast mosverifikimi të instrumentit, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9875, datë 14.2.2008.

iii) Produkti duhet të depozitohet vetëm në depozita të certifikuara nga DPM. Çdo depozitë duhet të jetë e pajisur me vërtetimin teknik të lëshuar nga ISHP-ja që konfirmon përmbushjen e kushteve teknike të tyre.

iv) Koncesionari i markimit/shënjimit (GFI) dhe DPD-ja kryejnë procedurat e monitorimit të produktit.

Në rast se nga shërbimi i kontrollit të markimit/shënjimit konstatohen produkte të pafiskalizuar, procedohet me masat ligjore sipas legjislacionit në fuqi nga ana e DPD-së. Në rast të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm sipas legjislacionit tatimor, si dhe të pajisjes fiskale, informohet DPT-ja, ISHP-ja dhe DPSH-ja.

v) Kontrolli i sistemit të monitorimit të qarkullimit bëhet nga strukturat e hetimit tatimor apo të kontrollit tatimor.

Në rast konstatimi:

- të mungesës/dëmtimit të sistemit të monitorimit të qarkullimit;
- të dhënave të patransmetuara;
- të përdorimit manual të sistemit;
- të subjektet penalizohen sipas ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

4. Procedurat e kontrollit sasior, cilësor dhe fiskal në rastet e prodhimit vendas të hidrokarbureve

4.1. Rafineri naftë, njësi prodhimi biokarburantesh dhe impiante përpunimi nënprodukte naftë

i) DPD-ja monitoron sasinë e lëndës së parë (naftë bruto) që hyn në rafineri për përpunim.

Monitorimi kryhet nëpërmjet sistemit elektronik, regjistrave të magazinës fiskale, rakordimeve mujore me doganën, kontralitra dhe peshore automobilistike.

ii) DPD-ja, ISHP-ja dhe subjekti kryejnë matjen e sasisë së nënprodukteve përfundimtare të prodhuara në magazinat fiskale të prodhimit/përpunimit, bazuar në certifikatën e kalibrimit të miratuar nga DPM-ja.

iii) ISHP-ja kryen marrjen e mostrës sipas procedurave ligjore në fuqi.



iv) ISHP-ja analizon mostrën në laborator dhe dërgon pranë DPD-së raport-analizën sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe metodikave përkatëse të standardeve.

a) Në rast se nga raporti i analizave rezulton se produkti është në përputhje me në standardet e miratuara, procedohet me lëvrimin e produkteve nga depozitat.

b) Në rast nga raport-analiza rezulton se produkti nuk plotëson këto standarde, ISHP-ja procedon sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, si dhe njofton DPD-në, e cila realizon analizimin e elementeve specifike sipas përcaktimeve në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat”. Në këtë rast nuk lejohet tregtimi në tregun e brendshëm.

v) DPD-ja administron dokumentin shoqërues të akcizës për dhënien e një destinacioni tjetër (eksport, lëvizje në pezullim, futje në magazinë të lirë) apo hedhjen për konsum sipas ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat”. Në rastin e hedhjes në konsum, DPD-ja administron DSHA-në, me të cilin konfirmohet kryerja e pagesave së akcizës. Dalja e produktit përfundimtar nga magazina fiskale realizohet vetëm pas matjes nga instrumente matëse, sipas procedurave ligjore në fuqi.

vi) Në momentin e hedhjes në konsum të produktit, koncesionari i markimit (GFI) kryen procesin e markim/shënjimit të produktit në autobot.

vii) DPD-ja verifikon dokumentacionin me të cilin pajiset subjekti tregtar përpara daljes nga rafineria/impianti. Ky dokumentacion përmban: DSHA, faturë shitjeje, kupon tatimor, konfirmimin e shërbimit të markimit nga GFI-ja, raport-analizën e ISHP-së dhe certifikatën e verifikimit të instrumentit matës.

4.2 Tregtimi me shumicë

i) Merret mostra e produktit nga ISHP-ja për kryerjen e kontrollit cilësor, e cila analizohet brenda 4 ditëve punë dhe raporti i analizës i dërgohet menjëherë subjektit.

a) Në rast se nga raporti i analizave rezulton se produkti është në përputhje me standardet e miratuara, lejohet tregtimi i tij.

b) Në rast se nga raport-analiza rezulton se produkti nuk plotëson këto standarde, procedohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999.

ii) Hedhja në treg e produktit realizohet nëpërmjet instrumenteve matëse si kontalitär dhe peshore automobilistike, të cilët duhet të jenë të verifikuara nga DPM-ja. Në rast mosvlerësimi konformiteti (mosverifikimi) të instrumentit matës, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9875, datë 14.2.2008.

iii) Koncesionari i markimit (GFI) dhe DPD kryejnë procedurat e monitorimit të markimit. Në rast se nga shërbimi i monitorimit të markimit konstatohen produkte të pafiskalizuara, procedohet me masat ligjore sipas legjislacionit në fuqi nga ana e DPD. Në rast të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm sipas legjislacionit tatimor, si dhe pajisjes fiskale, informohet DPT-ja, ISHP-ja dhe DPSH-ja.

iv) Kontrolli i sistemit të monitorimit të qarkullimit bëhet nga strukturat e hetimit tatimor apo kontrollit tatimor.

Në rast konstatimi:

- të mungesës/dëmtimit të sistemit të monitorimit të qarkullimit;
- të të dhënave të patransmetuara;
- të përdorimit manual të sistemit;
- subjektet penalizohen sipas ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

4.3 Tregtimi me pakicë

i) Merret mostra e produktit nga ISHP-ja për kryerjen e kontrollit cilësor, e cila analizohet sipas procedurave në fuqi dhe raporti i analizës i dërgohet menjëherë subjektit.

a) Në rast se nga raporti i analizave rezulton se produkti është në përputhje me standardet e miratuara, lejohet tregtimi i tij.

b) Në rast se nga raport-analiza rezulton se produkti nuk plotëson këto standarde, procedohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999.

ii) Hedhja në treg e produktit realizohet nëpërmjet instrumenteve matëse shpërndarëse të karburantit, të cilët duhet të jenë verifikuar nga DPM-ja. Në rast mosverifikimi të instrumentit, zbatohen dispozitat e ligjit nr. 9875, datë 14.02.2008.

iii) Produkti duhet të depozitohet vetëm në depozita të certifikuara nga DPM-ja. Çdo depozitë duhet të jetë e pajisur me vërtetimin teknik të lëshuar nga ISHP-ja që konfirmon përmbushjen e kushteve teknike të tyre.



iv) Koncesionari i markimit (GFI) dhe DPD kryejnë procedurat e kontrollit të markimit (GFI, DPD). Në rast se nga shërbimi i kontrollit të markimit konstatohen produkte të pafiskalizuara, procedohet me masat ligjore sipas legjislacionit në fuqi nga ana e DPD-së. Në rast të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm sipas legjislacionit tatimor, si dhe pajisjes fiskale, informohet DPT-ja, ISHP-ja dhe DPSH-ja.

v) Kontrolli i sistemit të monitorimit të qarkullimit bëhet nga strukturat e hetimit tatimor apo kontrollit tatimor.

Në rast konstatimi:

- të mungesës/dëmtimit të sistemit të monitorimit të qarkullimit;
 - të të dhënave të patransmetuara
 - të përdorimit manual të sistemit
- subjektet penalizohen sipas ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

5. Procedurat e kontrollit sasior, cilësor dhe fiskal në rastet e eksportit të prodhimit vendas

a) Çdo produkt i prodhimit vendas që do të eksportohet, përpara nisjes së procedurave të eksportimit nga DPD-ja, duhet të jete i shoqëruar me raport analize të lëshuar nga ISHP-ja.

b) Në rastin e vendosjes së këtyre produkteve nën regjimin e eksportit, procedohet nëpërmjet depozitimit të dokumentit shoqërues administrativ DSHA dhe deklaratës doganore të eksportit, e cila shoqërohet nga dokumentacioni specifik. Kontrolli i procedurës së rieksporit realizohet nga DPD-ja.

c) Në rast konstatimi të elementeve të veprës penale, DPD-ja njofton strukturat e DPSH-së, DPT-së dhe ISHP-së. Në rastet kur strukturat e tjera të procedimit penal kanë informacion për prezencën e veprave penale, njoftojnë autoritetet doganore dhe tatimore.

5.1 Shoqëritë e prodhimit të naftës bruto:

i) Ndalohej tregtimi/qarkullimi i naftës bruto jashtë pikave të lëvrimit të miratuara nga AKBN-ja. Në rast konstatimi të shitjes së naftës bruto jashtë pikave të lëvrimit të miratuara nga AKBN-ja, DPD-ja njofton Albpetrol-in, AKBN-në, DPT-në dhe DPSH-në.

ii) DPD-ja administron fletën e peshës, dokumentin shoqërues administrativ dhe të dhënat e kalimatësit për matjen e sasisë së produktit në rezervuarët e kalibruar nga DPM në pikat e lëvrimit.

iii) ISHP-ja realizon marrjen e mostrës sipas procedurës ligjore në fuqi.

iv) Analizimi i mostrës në laborator dhe dërgimi i raport analizës në DPD bëhet nga ISHP-ja, sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rast se rezulton se produkti nuk plotëson standardet e miratuara të cilësisë, zbatohet ligji nr. 8450, datë 24.2.1999.

v) DPD-ja administron dokumentin shoqërues të akcizës për dhënien e një destinacioni tjetër (eksport, lëvizje në pezullim, futje në magazinë të lirë) sipas ligjit nr. 61/2012 “Për akcizat”.

vi) Koncesionari i markimit (GFI) kryen markimin/shënjimin e produktit në pikën e lëvrimit, në momentin e daljes së produktit nga magazina fiskale.

5.2 Tregtimi me shumicë

i) Në rastin e tregtimit me shumicë, nga ISHP-ja merret mostra e produktit për kryerjen e kontrollit cilësor, e cila analizohet brenda 4 ditëve punë dhe raporti i analizës i dërgohet menjëherë subjektit.

a) Në rast se nga raport i analizave rezulton se produkti është në përputhje me standardet e miratuara, lejohet tregtimi i produktit.

b) Në rast se nga raport-analiza rezulton se produkti nuk plotëson këto standarde, procedohet sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999.

ii) Hedhja në treg e produktit realizohet nëpërmjet instrumenteve matëse, si kontaliter dhe peshore automobilistike, të cilat duhet të jenë verifikuar nga DPM-ja.

Në rast mosvlerësim konformiteti (mosverifikimi) të instrumentit matëse zbatohet ligji nr. 9875, datë 14.2.2008.

iii) Monitorimi i kryerjes së markimit (GFI, DPD). Në rast se nga shërbimi i monitorimit të markimit konstatohen produkte të pafiskalizuara, procedohet me masat ligjore sipas legjislacionit në fuqi nga ana e DPD-së. Në rast të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm sipas legjislacionit tatimor, si dhe pajisjes fiskale, informohet DPT-ja, ISHP-ja dhe DPSH-ja.

iv) Kontrolli i sistemit të monitorimit të qarkullimit bëhet nga strukturat e hetimit tatimor apo kontrollit tatimor.

Në rast konstatimi të:



- mungesës/dëmtimit të sistemit të monitorimit të qarkullimit;
- të dhënave të patransmetuara;
- përdorimit manual të sistemit;
- subjektet penalizohen sipas ligjit “Për procedurat tatimore”.

v) DPD-ja verifikon në mënyrë periodike, mujore, DSHA për ngarkesat që dalin nga magazinat fiskale dhe i rakordon ato me sistemin e të dhënave *Asycuda* sipas ligjit 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”.

DPD-ja verifikon dokumentacionin me të cilin pajiset subjekti tregtar përpara daljes nga pika e lëvrimit. Ky dokumentacion përmban: DSHA, faturë tatimore/kupon tatimor, konfirmimin e shërbimit të markimit nga GFI-ja, raport-analizën e ISHP-së dhe certifikatën e verifikimit të instrumentit matës të subjekteve të autorizuar nga DPM-ja.

6. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet institucioneve

6.1. Njoftimi i menjëhershëm për shkeljet e konstatuara

Nëse gjatë zbatimit të detyrave të tyre ligjore, institucionet e përfshira në këtë udhëzim konstatojnë shkelje, njoftojnë menjëherë strukturat e tjera kompetente dhe në çdo rast, jo më vonë se 12 orë nga momenti i konstatimit të saj. Njoftimi i bëhet pikës së kontaktit të institucioneve sipas listës në paragrafin 8 më poshtë.

Pas informacionit të marrë, institucioni kompetent ndërmerr masat teknike, organizative, funksionale e ligjore brenda 24 orëve.

Masat e marra dhe rezultatet e arritura raportohen në bazë javore pranë grupit koordinues ndërinstitucional për kontrollin e naftës dhe nënprodukteve të tyre.

6.2. Shkëmbimi i informacionit dhe raportimi
Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), Inspektorati Shtetëror Përgjegjës (ISHP), Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), Koncesioni i Markimit (GFI), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) shkëmbejnë informacione në bazë javore, sipas fushave përkatëse. Institucionet e mësipërme raportojnë dhe rekomandojnë te grupi koordinues për kontrollin e naftës dhe nënprodukteve të tyre, i cili analizon dhe

përpunon informacionin dhe brenda 72 orëve jep udhëzimet për strukturat përkatëse.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), Inspektorati Shtetëror Përgjegjës (ISHP), Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM), Koncesioni i Markimit (GFI), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Drejtoria e Policisë së Shtetit:

a) Shkëmbejnë informacionin që sigurojnë ose disponojnë, i cili shërben si bazë për evidentimin, rakordimin, zbatimin dhe përmirësimin e legjislacionit të fushës ku operojnë.

b) Nëse informacioni përmban të dhëna të natyrës penale, ai i vihet në dispozicion pa vonesë sipas shkallës së emergjencës (telefon, faks, e-mail, shkresë) Drejtorisë së Policisë së Shtetit, e cila bashkëpunon dhe koordinon veprimet me institucionet e mësipërme për verifikimin, ndjekjen, dokumentimin deri në referim të veprës penale prokurorisë kompetente.

c) Bashkëpunojnë në parandalimin, kontrollin, zbulimin, dokumentimin dhe procedimin e shkeljeve të legjislacionit të fushës konkrete nga ana e operatorëve ekonomikë.

d) DPD-ja informon çdo muaj ISHP-në në lidhje me sasitë e produkteve të zhdoganuara dhe ISHP-ja informon çdo muaj DPD-në për sasitë e analizuara/certifikuara nga ISHP-ja para zhdoganimit.

e) Inspektorati Shtetëror Përgjegjës shkëmben informacion dhe bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në lidhje me subjektet informale të tregtimit të hidrokarbureve.

f) ISHP-ja informon menjëherë dhe në çdo rast jo më shumë 24 orë GFI, DPD dhe DPT për çdo raport analizimi jashtë standardit.

g) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve shkëmben informacion dhe bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në lidhje me:

i) të dhëna në kohë reale midis sistemeve respektive për sa u përket të informacioneve të cilat ndikojnë dhe lidhen drejtpërsëdrejti apo në mënyrë të tërthortë me mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe doganore, si dhe parandalimin e evazionit fiskal dhe të aktiviteteve të tjera të paligjshme në sektorin e naftës dhe nënprodukteve të saj.



ii) të dhënat e import-eksportit të kryera nga operatorë ekonomikë në sektorin e naftës dhe nënprodukteve të saj.

iii) të dhëna mbi regjistrin e operatorëve aktivë të regjistruar në regjistrin e administratës tatimore, të cilët operojnë në sektorin e naftës dhe nënprodukteve të saj.

iv) të dhëna mbi subjektin/subjektet për të cilët janë konstatuar shkelje të natyrës fiskale dhe janë aplikuar penalitete në sektorin e naftës dhe nënprodukteve të saj.

v) informacione të detajuara në rast të mospërputhjes së të dhënave doganore dhe tatimore në sektorin e naftës dhe nënprodukteve të saj.

h) Institucionet e përfshira sipas këtij udhëzimi i japin Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve informacion në lidhje me të dhënat të konstatuara gjatë verifikimeve të ndryshme, të cilat ndikojnë dhe çojnë në llogaritjen e saktë të detyrimeve tatimore.

i) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) jep informacion për Inspektoratin Shtetëror Përgjegjës (ISHP), në lidhje me matjen e kapacitetit të depozitave, para se subjekti të pajiset me lejen e ushtrimit të aktivitetit.

j) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) shkëmben informacion me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në lidhje me subjektet e palicencuara dhe të paregjistruara.

k) Institucionet e mësipërme, nëse kundërshtohen ose pengohen në terren në ushtrimin e funksioneve shtetërore/publike, njoftojnë menjëherë strukturat më të afërta rajonale policore për sigurinë publike dhe DPSH.

7. Grupi koordinues ndërinstitucional për kontrollin e hidrokarbureve

Grupi koordinativ ndërinstitucional koordinohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjeve dhe përbëhet nga përfaqësues të caktuar nga të gjitha institucionet, si më poshtë:

a) Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjeve;

b) Ministria e Energjisë dhe Industrisë;

c) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD);

d) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT);

e) Inspektorati Shtetëror Përgjegjës (ISHP);

f) Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM);

g) Koncesioni i Markimit (GFI);

h) Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN);

i) Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Ky grup brenda 72 orëve nga momenti i marrjes së informacionit, e analizon dhe e përmbledh dhe kur është e nevojshme, nxjerr rekomandime për institucionet përkatëse sipas rastit.

8. Pikat e kontaktit për çdo institucion

a) Në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave (DPD), pika e kontaktit do të jetë zëvendësudrejtori i Përgjithshëm i Doganave që mbulon akcizën.

b) Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), pika e kontaktit do të jenë Drejtori i Hetimit Tatimor dhe Drejtori i Kontrollit Tatimor.

c) Në Inspektoratin Shtetëror Përgjegjës (ISHP), pika e kontaktit do të jetë Kryeinspektori.

d) Në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM), pika e kontaktit do të jetë Drejtori i Përgjithshëm.

e) Në Koncesionin e Markimit (GFI), pika e kontaktit do të jetë Drejtori i Përgjithshëm.

f) Në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), pika e kontaktit do të jetë Drejtori i Përgjithshëm.

g) Në Drejtorinë e Policisë së Shtetit, pika e kontaktit do të jetë Drejtori i Drejtorisë për Krimet Ekonomike e Financiare.

9. Shkeljet e legjislacionit, penalitetet dhe institucionet e përfshira.

Në rastin e konstatimit të shkeljeve, secili institucion sipas fushës së përgjegjësisë, zbaton dënimet administrative të parashikuara në legjislacionin e fushës që mbulon, të natyrës administrative.

Në rastet e konstatimit të shkeljeve administrative dhe/ose penale nga secili institucion, dhe kur shkelja ka pasoja në shmangien e detyrimeve që ndiqen nga institucione të tjera, institucioni konstatues është i detyruar t'ia referojë problemin institucionit që ka lidhje me çështjen.

Në rastin e konstatimit të shkeljeve me elemente të veprës penale, çdo institucion do ta referojë çështjen në strukturat për krimet ekonomike dhe financiare në Policinë e Shtetit, si dhe në prokurorinë kompetente.

10. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Inspektorati Shtetëror Përgjegjës, Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë,



Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore,
Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet
në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCËS

Shkëlqim Cani

**MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK,
TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES**

Arben Ahmetaj

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME

Saimir Tahiri

MINISTRI I ENERGJISË DHE INDUSTRIË

Damian Gjikhuri

KËRKESË

Nr. 3522/1, datë 4.5.2015

**PËR SHPRONËSIM ME INTERES
PUBLIK**

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall
kërkesën për shpronësim, me interes publik, të
pasurive të paluajtshme të tipit “Tokë bujqësore,

Qarku: Korçë

Komuna: Leskovik

Fshati: Vrepcke

**LISTA SHITESË E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 KV
ERSEKË -PËRMET**

Tabela 1

Nr.	Nr. shtyllës sipas projektit	Emri	Mbiemri	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. pasurie	Sipërfaqja e shpronësimit m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera kompensimit/lekë
1	72	Xhelal Esat Luan	Mezini	Pyll	3826		16.59	85	1410.15
2	73	Xhelal Esat Luan	Mezini	Pyll	3826		19.65	85	1670.25
3	74	Xhelal Esat Luan	Mezini	Pyll	3826		19.65	85	1670.25
	Totali						55.89		4750.65

arë, truall, kullotë” që preken nga “Ndërtimi i
linjës 110 kv, Ersekë-Përmet”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është:
“OST” sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi në shtyp kërkojmë
të vëmë në dijeni personat që preken nga ky
shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në
sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë
që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës
të llogaritur nga komisioni i posaçëm i
shpronësimit pranë Ministrisë së Energjisë dhe
Industrisë për secilin pronar sipas listës emërore
të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve nga data e fundit e
publikimit, personat që kanë emrin në listën
emërore kanë të drejtën të paraqiten pretendimet
e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në
Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë pranë
komisionit të posaçëm të shpronësimit.

**MINISTRI I ENERGJISË DHE
INDUSTRIË**

Damian Gjikhuri

**KËRKESË****Nr. 2730, datë 7.5.2015****PËR SHPRONËSIM ME INTERES
PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Maminas-Gjiri i Lalzit”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i

këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit “objekte”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 7 384 399 (shtatë milionë e treqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI SHPRONESIMEVE

**LISTA E PRONARËVE TË OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR "MAMINAS-GJIRI I LALËZIT"**

Nr.	Emri - Atësia - Mbiemri	Nr. Z. Kad.	Nr.Pasurisë	Sipërfaqe ndërtimi	Lloji i objektit	Vlera (Lekë)	Shënime
1	Sefer Luku	2590	443/10	56m2	Ndërtesë	2,007,970	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Hasan Zenel Sallaku	3137	62/11	72m2	Objekt banimi	2,515,344	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Kalem Sallaku	3137	63/21		Mur rrethues	347,971	Leje ndërtimi
4	Naim Zyber Gjergji	2065	38/33	30m2	Ndërtesë	1,391,972	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Fadil Hoxha	3137	76/5	66m2	Objekt shërbimi	629,094	Leje ndërtimi
6	Rustem Hoxha	3137	62/9		Mur rrethues	492,048	Leje ndërtimi
	SHUMA TOTALE					7,384,399	

**KËRKESË****Nr. 2733, datë 7.5.2015****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Qafë Thanë-Lin-Pogradec loti II (shtesat)”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i

këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit, “objekt, truall dhe arë”.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit është 32 247 000 (tridhjetë e dy milionë e dyqind e dyzet e shtatë mijë) lekë.

**MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto**

Nr.	Emri - Atësia - Mbiemri	Nr. Z. Kad	Nr.Pasuri së	Sipërfaqe ndërtimi (m2)	Lloji i pasurisë	Vlera objektit (Lekë)	Sip. truall&arë (m2)	Çmimi (lek/m2)	Vlera (lek)	Vlera Totale (lek)	Shënime
1	Zihni Selajdin Muçi	2973	512/11	265	Lokal, Banesë 1 kt	12,923,495				12,923,495	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Shoqëria "2F Grup" Shpk Administrator Arjan Murataj	2648	584/1	23	Karburant	3,150,200				3,150,200	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Fadil Alush Duraku	2648	731/8	51	Karburant "Taçi"	12,571,245	364	1,640	596,960	13,168,205	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Neshet Hoxha	2648	582/1/30	62	Ndërtesë 1kt+podrum	1,303,207				1,303,207	Leje ndërtimi
5	Izet Sejat Hoxha	2648	582/1/31		Arë		13	200	2,600	2,600	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Lavderim Neki Seitllari	2648	582/1/8	70	Ndërtesë 1kt	1,246,645	210	1,440	302,400	1,549,045	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Idajet Ibrahim Palla	2648	530/8		Truall		70	1,640	114,800	114,800	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Qerim Hoxha	3665	253/6		Arë		40	200	8,000	8,000	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Xhevahir Torollari	3665	253/21		Arë		10	200	2,000	2,000	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Nebi Dajlan Manellari	8582	20/180		Arë		40	217.5	8,700	8,700	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Rushit Ali Malellari	8582	20/167		Arë		13	217.5	2,828	2,828	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Mehmet Hamdi Malellari etj	8582	20/140		Arë		34	217.5	7,395	7,395	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Figirije Murat Malellari etj	8582	20/143		Arë		17	217.5	3,698	3,698	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Gjylke Ibrahim Xhambazi etj	8582	20/179		Arë		13	217.5	2,828	2,828	Konfirmuar nga ZVRPP
SHUMA TOTALE										32,247,000	

KËRKESË**Nr. 1972/6, datë 7.5.2015****PËR SHPRONËSIM ME INTERES PUBLIK**

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i projektit “Zgjerimi i rrugës “Don Gjon Buzuku”, rijetësimi i sheshit të xhamisë “Iljaz Bej Mirahori”, rindërtimi i Kullës Historike të Sahatit, rijetësimi i sheshit të hyrjes,

si dhe rikonstruksioni i disa rrugicave të Pazarit Historik”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Bashkia Korçë. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes



publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP”, do të likuidohen për efekt shpronësimi pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave që do të miratojë kërkesën për shpronësim.

Vlera totale e shpronësimit është 30 144 830 (tridhjetë milionë e njëqind e dyzet e katër mijë e tetëqind e tridhjetë) lekë.

MINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN
Eglantina Gjermeni

Zgjerimi i Rrugës "Don Gjon Buzuku", Rifjetësimi i Sheshit të Xhamisë "Hajaz Bej Mirahori", Rindërtimi i Kullës Historike të Sahatit, Rifjetësimi i Sheshit të Hyrjes dhe Rikonstruksioni i Disa Rrugëve të Pazarit Historik								
Nr. Rendor	Vol.	Faq.	Nr. Pasurie	Emër Atësi Mbiemër	Lloji i Pas.	Truall. (m2)	çmimi për m2	Vlera Total per Shpronësim
1	38	198	3/959	Shtet	Shesh	2665	8537	0
2	12	117	3/664	Katerina Kristaq Veriga + bpr	Truall	20.77	8537	177,313
3	11	56	3/492	Ana Shain Veriga + bpr	Truall	20.77	8537	177,313
4	17	67	3/575	Ismail Adem Zhilla	Truall	36.18	8537	308,869
5	17	223	3/585	Jani Dhokë Simo	Truall	42.88	8537	366,067
6	21	5	3/615	Romeo Niko Titka	Truall	20.00	8537	170,740
7	12	100	3/654	Petrika Kozari, Stavri Kozari	Truall	74.55	8537	636,433
8	28	157	3/358	Nedibe Sejdarasi + bpr	Truall	20.00	8537	170,740
9	24	33	3/686	Gjinovefa Zado	Truall	19.00	8537	162,203
10	14	110	3/535	Jeta Aliqemal Feimi (Tuxhari)	Truall	46.66	8537	398,336
11	14	179	3/532/1	Sotirak Petraq Tego	Truall	93.33	8537	796,758
12	38	199	3/960	Myftinia Korçë	Truall	105.00	8537	896,385
13	15	157	3/537	Bashkëpronar (Nrb/pronar 33)	Truall	355.00	8537	3,030,635
14	36	139	3/780	Ymer Ahmeti	Truall	42.50	8537	362,823
15	18	67	3/587	Kristaq Lubonja + bpr	Truall	28.80	8537	245,866
16	11	3	3/643	Romeo Xhuvi Zallëmi	Truall	50.40	8537	430,265
17	18	108	3/199	Koço Katundi + bpr	Truall	22.30	8537	190,375
18	24	34	3/687	Gjinovefa Zado	Truall	35.00	8537	298,795
19	11	177	3/645	Dhimitri Zici + bpr	Truall	22.80	8537	194,644
20	17	27	3/576	Marjeta Stralla + bpr	Truall	34.20	8537	291,965
21	17	28	3/577	Marjeta Stralla + bpr	Truall	21.00	8537	179,277
22	18	171	3/590	Vasillaq Orgocka + bpr	Truall	24.00	8537	204,888
23	17	29	3/578	Marjeta Stralla + bpr	Truall	18.00	8537	153,666
24	18	236	3/595	Dylber Kosova	Truall	18.90	8537	161,349
25	18	241	3/598	Kleanthi Papakozma +bpr	Truall	30.24	8537	258,159
26	14	179	3/531	Nikoleta Jani Çupata	Truall	42.40	8537	361,969
27	16	248	2/85	Shemsi Shehu dhe bpr	Truall	1347.00	8537	11,499,339
28	35	182	2/88	Ilia Manol Emanuel + bpr	Truall	879.00	8537	7,504,023
29	16	53	3/564	Dhorothea Stratobërdha + bpr	Truall	60.40	8537	515,635
VLERE TOTALE PER SHPRONËSIM								30,144,830

KËRKESË

Shtetasi Dalan Maliqaj, i datëlindjes 20.11.1949, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shpalljen të zhdukur të shtetasit Anri Maliqaj, i datëlindjes 20.2.1982.

KËRKUES
Dalan Maliqaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 196 lekë